



DITARI JAVOR

25 - 31 Mars

VIZITA E MINISTRIT TË DREJTËSISË DHE SIGURISË TË HOLANDËS Z. FREDINAND GRAPPERHAUS

U diskutua mbi forcimin e shtetit të së drejtës dhe mbi rëndësinë e një sistemi drejtësie të konsoliduar për Shqipërinë. Gjatë bisedës dypalëshe ministri u njoh me rezultatet konkrete dhe progresin që ka bërë vendi ynë në përmbushjen e objektivave dhe prioriteteve të vendosura nga qeveria. Ministri Grapperhaus, theksoi rëndësinë dhe rolin kyç që luan procesi i vetingut në vendosjen e një sistemi të ri drejtësie për vendin tonë. Në vijim, z. Grapperhaus siguroi që Holanda do ta mbështesë dhe ndihmojë Shqipërinë që të ecë përpara në procesin e integritimit evropian.

VIZITË NË KOSOVË

Ministri i Drejtësisë i Kosovës, z. Abelard Tahiri u njoh me hapat e ndërmara për zbatimin e Reformës në Drejtësi si dhe ngritjen e institucioneve të reja në Drejtësi. Vizita vazhdoi me kryetaren e Gjykatës Kushtetuese, Arta - Rama (Hajrizi) si dhe kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Enver Peci.

VIZITË NË QARKUN LEZHË

Nënshkruhet marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Bashkisë Kurbin për të miturve në konflikt me ligjin, duke i mbajtur të miturit larg izolimit në burg.

Vizitë blic në IEVP Shën Koll, pas shkeljeve të ndodhura së fundmi. Analizë pune edhe për stafin drejtues.

U zhvillua dhe analizë pune për dy agjencitë, ZVRPP dhe ALUIZNI.

Analizë pune u zhvillua dhe në dy agjencitë, zyra rajonale e Shërbimit të Provës dhe zyra rajonale e Përmbartimit.

TASK FORCA ANTIKORRUPSION

Task Forca Antikorrupsion ka kryer kontroll në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kavajë, ku në përfundim të këtij kontrollit janë rekomanduar 17 masa disiplinore.

NËNSHKRIMI I MARRËVESHJES MES SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS DHE SSR

U nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit midis Shkollës së Magjistraturës dhe Qendrës së Trajnimeve dhe Studimeve për Gjqësorin në Utreht të Hollandës. Z. Grapperhaus, shprehu mbështetjen e plotë të Hollandës në nismën monumentale të Reformës në Drejtësi në Shqipëri. E cilësoi monumental procesin e vetingut dhe u tha magjistratëve të rinj, se ata janë shpresa e Shqipërisë, pasi vetëm nëpërmjet forcimit të shtetit të së drejtës, vendi do integrohet në BE.